



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI I LËNDËS

GJUHË ANTIKE GREKE

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 10 leksione / 30 seminare
Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti I/ Semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kursi u ofron studentëve njohuri bazë rreth greqishtes së vjetër, historisë, karakteristikave të saj duke filluar me sistemin e eptimit, ndërtimin sintaksor, fjalëformimin, etj.

Objektivat e përgjithshme lëndore: Nëpërmjet prezantimit të teksteve të autorëve të ndryshëm studenti duhet të zbulojë themelet e hershme e të palëkundura të mendimit njerëzor, rëndësinë e botës antike greke si një nga bazat e qytetërimit të sotëm evropian.

Objektivat e specifike lëndore: Studenti duhet të njihet me zhvillimin diakronik të gjuhës greke, të jetë në gjendje të lexojë dhe të interpretojë një tekst të nivelit fillestar

në greqishten e vjetër, të njihet me llojet e ndryshme të lakimit të emrave, me mënyrat e foljeve si dhe të formojë kohët e mënyrës dëftore, të marrë njohuritë fillestare mbi ndërtimin sintaksor të fjalive.